

Durrës, më 09.05.2017

Bashkim Kopliku

Mobile: +355(0)672858090

Phone: +355(0)52 223663

E-mail: bkopliku@gmail.com

Adresa: L. 12, Rr. Mozaikëve, P. 917, Durrës

**Parashtrim në proces gjyqësor të datës 10.05.2017 me gjyqtare znj.
Besjana Garxenaj,
kundër kërkesëpadisë së datës 31.03.2017 (Fletë-thirrje data 24.04.2017,
Nr. 1268 Akti), të paditësit z. Bujar Nishani**

Bazuar në nenin 172 të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, sot më 10.05.2017 po paraqes me shkrim shpjegimet dhe pretendimet e mia, në seancën gjyqësore përkatëse, të drejtuar nga gjyqtarja znj. Besiana Garxenaj

1—Në këtë pikë, po sjell provën e parë (shih bashkëngjitur dokumentin me titull “Nga babi ka pasur disa probleme, ndërsa nga pjesa e nënës jo”, ku ka material të marrë nga faqja zyrtare e Presidencës) **se Shkrimi im publicistik** (shih bashkëngjitur një kopje të Shkrimit në fjalë, me titull “Zoti president, heshtja është faj, kur ushqen gënjeshtren”, Botuar dt. 21.02.2017, Durrësi Bulevard), **ndaj të cilit bëhet ky gjykim, është i vërtetë në objektin kryesor që ka, në kritikën ndaj thënieve të pavërteta, e në kritikën ndaj falsifikimit të biografisë së Presidentit z. Bujar Nishani** (që është dhe paditësi në këtë proces gjyqësor), **që i ka bërë znj Edit Harxhi, në një emision televiziv. Në atë emision, Znj Harxhi, ndërmjet të tjerave deklaroi se Presidenti aktual, z. Nishani [...], qenkësh bir i një familje tejet antikomuniste, të persekutuar e të shpronësuar skajshëm nga regjimi komunist”.**

Prova që kam sjellë vërteton se qëndrimi i familjes së paditësit, ka qenë krejt tjetër me atë që u paraqit në atë emision—janë fjalët e vetë paditësit që e vërtetojnë këtë. Pra vërtetohet se deklarata e znj Harxhi është së krejt e pavërtetë, më e vogla që mund të thuhet është një hiperbolizim i skajshëm. Në vijim po citoj nga prova e sjellë:

Gazetari: Familja juaj ka pasur ndonjë problem me komunizmin?

Presidenti Nishani: Nga babi ka pasur disa probleme, ndërsa nga pjesa e nënës jo.

[...]

Gazetari: Me se merreshin prindërit tuaj?

Presidenti Nishani: Të dy prindërit i kam pasur arsimtar, **babai ka shërbyer rreth 40 vjet në gjimnazin e Durrësit, nëna gjithashtu arsimtare po në Durrës derisa ka dalë në pension.**

Prova flet vetë e qartë kundër sa tha znj. Harxhi, dhe e bën krejt të drejtë ndërhyrjen time me një shkrim publicistik: sa shkruan paditësi vetë, është shumë larg me qenien “familje tejet antikomuniste, e persekutuar dhe e shpronësuar skajshëm nga regjimi

komunist.” siç u tha në emisionin televiziv, gjë që dhe shkaktoi reagimin tim me shkrimin tim publik.

Por, po të kesh njohjen minimale për realitetin e regjimit komunist shqiptar, **dallon edhe absurdin edhe në sa deklaroi paditësi: edhe “baba ka pasur disa probleme me komunizmin”, e njëkohësisht edhe “babai ka shërbyer rreth 40 vjet në gjimnazin e Durrësit”!!! Dihet botërisht se gjatë regjimit komunist nuk të linte njeri 40 vjet arsimtar në gjimnaz, mu në mes të Durrësit, po të kishe “vetëm një problem biografik”, dhe jo më “disa probleme biografike” (më në hollësi, shih pikën 4, nëntitulli “Fakte të njohura botërisht”, pika c, më poshtë po në këtë dokument).**

2—Paditësi, në kërkesëpadinë në shqyrtim, e nxjerrë veten të persekutuar nga regjimi komunist, me një pretendim fare të pamjaftueshëm për një klasifikim të tillë (shih faqen 6 e 7 të kërkesëpadisë, në paragrafin e parë), me shpronësimin e familjes së babës.

Ja se ç’ shkruan paditësi, në faqen 6 e 7 të kërkesëpadisë, pika 13:

“Familja e paditësit ka qenë drejtpërdrejt pjesë e goditjes nga rregjimi monist, në ato elementë të cilët janë të shenjtë dhe të patjetërsueshëm, prona private. Familja e z. Nishani është shpronësuar duke ju konfiskuar padrejtësisht pronat e trashëguara ndër breza” [gabimet gjuhësore janë të origjinalit—B.K.]

Konfiskimin e pronave, paditësi e konsideron si kriter të mjaftueshëm për të thënë se ka pasur persekutimit, apo goditje nga regjimi komunist. Po të ishte ky kriter i mjaftueshëm, i bie se edhe vetë Enver Hoxha, edhe të gjithë hierarkët (anëtarë të Byrosë Politike, prokurorë, gjykatës, sekretarë partie, etj.) që terrorizuan për pothuaj 50 vjet popullin shqiptar, edhe ata persekutorë do të dilnin të persekutuar, sepse bijtë e tyre, për secilin prej tyre, në analogji me paditësin, do të mund të thoshin: “baba ka qenë drejtpërdrejt pjesë e goditjes nga regjimi komunist, në ato elementë të cilët janë të shenjtë dhe të patjetërsueshëm, prona private”. Për secilin nga persekutorët që përmenda, bijtë e tyre, në analogji me paditësin, mund të thoshin se “janë shpronësuar duke ju konfiskuar padrejtësisht pronat e trashëguara ndër breza”. Komunizmi zhduku të gjithë pronën private, kur pothuaj e gjithë prona në Shqipëri ishte private para ardhjes së komunizmit, pra të gjithë u shpronësuan, me komunistë dhe me antikomunistë.

Besoj se nuk ia vlen ta zgjas për të provuar se paditësi nuk ka sjellë dot asnjë provë të vetme të goditjes politike të familjes së tij, nga regjimi komunist, sepse nuk ka pasur një goditje të tillë, e siç do ta vërtetoj në vijim, e kundërta ka qenë e vërtetë, që familja e tij është me “bëma në mbështetje të shtypjes komuniste të popullit, të kryera nga etërit e kësaj familjeje superkomuniste”, tamam siç e kam shkruar në shkrimin tim.

3-Në këtë pikë, do të vërtetoj se kërkesëpadia nuk qëndron fare as juridikisht e as moralisht, sepse:

-Nga ana formale juridike, nuk ka asnjë frazë në Kushtetutën tonë, apo në ligjet tona, që denigron ndonjë person, mbi bazën se çfarë kanë qenë etërit e familjes së tij, apo çfarë

kanë bërë ata. Njerëzit përgjigjen për bëmat e tyre personalisht, e jo të të afërmeve të tyre, të etërve të familjeve të tyre.

-Gjithashtu, paditësit nuk i është shkaktuar asnjë dëm, siç pretendon Ai në faqen 4 pika 6 e kërkesëpadisë, pra për rrjedhojë as që ka të bëjë neni 609 (dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë ...) i Kodit Civil që citohet nga paditësi, e nuk kanë të bëjnë as të gjitha faqet 4, 5 dhe 6 të kërkesëpadisë, ku janë shkruar e kopjuar mekanikisht faqe të tëra nga legjislacioni, por që nuk kanë asnjë lidhje me rastin konkret.

-Gjithashtu, thëniet në shkrimin tim, që nga paditësi janë cituar dhe janë bërë formalisht shkak i kësaj kërkesëpadie, nuk mund të jenë objekt gjykimi, sepse biografia e familjes nuk sjell pasoja, pra nuk ngarkon me pasoja juridike, gjë që kërkohet edhe në nenin 7 të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, pra nuk i shkakton një njeriu sot, në ndryshim me kohën e komunizmit, asnjë dëm, as moral as material.

-Gjithashtu, kjo kërkesëpadi është e pavlefshme, në frymën e Nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, sepse paditësi nuk ka përse të ketë asnjë “interes të ligjshëm në njohjen ose rrëzimin e pretendimit”, pra faktikisht nuk ka asnjë interes të ligjshëm për sa është thënë në Shkrim: asnjë pasojë nuk ka sot në Shqipërinë demokratike, jokomuniste, se çfarë kanë qenë apo si kanë vepruar pjesëtar të familjes në breza, qofshin pro-, qofshin antikomunistë. Kjo është një nga fitoret e mëdha të arritura nga Shqipëria e pas vitit 1991.

-Gjithashtu, sa kam shkruar shkurtimisht në shkrimin tim publicistik, që citohen në kërkesëpadi, nuk kanë fare karakter denigrues dhe jo etik, siç pretendon paditësi (shih faqe 4 të Akt-padisë, paragrafi 6).

-Nuk është thënë asnjë fyerje, asnjë thënie me karakter denigrues dhe jo etik në drejtim të paditësit, siç pretendon Ai, (shih faqe 2 të kërkesëpadisë, pika 2., paragrafi i parë dhe i dytë i saj).

-Bile, të gjitha këto pretendime të paditësit, janë në vetvete antikushtetues, dhe kundër frymës demokratike të përqafuar nga Shqipëria, pas rënies së komunizmit, sepse paditësi duke u ndjerë i fyer nga këto fjalë etj. etj., po prezumon se qenkësh një e metë, apo qenkësh një e keqe të kesh një familje me prejardhje komuniste e të tjera të tilla. Nuk është fare kështu, sepse në shtetin tonë demokratik, askush nuk ka përse ndjehet “i denigruar, apo i trajtuar në mënyrë jo etike” etj., nëse rezulton se etërit e familjes së tij kanë qenë “superkomunistë”, apo “kanë shtypur njerëzit në emër të ideve komuniste” etj. Vetëm në komunizëm, në kohën e luftës së klasave, njerëzit denigroheshin, privoheshin nga të drejtat e tyre, mbi bazën e biografisë së etërve të familjeve, bile një kohë u pat kërkuar të shihej biografia “deri në shtatë brez”.

-Sot, nëse të thonë saç kam shkruar unë për etërit e familjes së paditësit, nuk je fare i denigruar, as në qëndrimet dhe sjelljet e përditshme të njerëzve ndaj teje.

Sa thashë në përgjithësi në paragrafin më lart, po e ilustruj me një shembull konkret nga jeta politike e këtyre ditëve. Në një intervistë të Presidentit të ri, z. Ilir Meta, dhënë në televizionin Klan, më datë 1.05.2017, ai thotë me të qeshur se babën e ka pasur enverist, bile edhe se e ka akoma të tillë. Ja fjalët e Presidentit të ri: “Ditën që vdiq Enver Hoxha, babai më qëllloi me shpullë, e donte shumë”. Pra shumica janë si President i ri që e merr me të qeshur që babai i tij, e jo më larg te “etërit e familjes”, praktikisht ka qenë “me bëmat në mbështetje të shtypjes komuniste të popullit”, ka qenë superkomunist.” (shih shkrimin bashkangjitur “Ilir Meta: Ditën që vdiq Enver Hoxha, babai më qëllloi me shpullë, e donte shumë”).

Duket se paditësi ka rënë nën presionin e zhargonit të disa titullarëve aktualë të Partisë Demokratike, që po deformatojnë programin fillestar të kësaj partie, duke u futur, si në kohën e komunizmit, në një luftë biografish, duke u marrë me etërit e familjeve të kundërshtarëve të tyre politikë, duke i quajtur “bllokmen” e të tjera, sepse gjyshat, apo dhe etër edhe më të largët në familjen e tyre, paskëshin qenë superkomunistë. **Këto në thelb janë qëndrime antikushetuese dhe kriptokomuniste.**

Pra, mbi bazën e sa thashë, rezulton se fjalët që kam thënë në adresë të etërve të familjes së paditësit, as ligjërisht e as moralisht nuk janë në vetvete ofenduese, dhe prandaj nuk kanë si të jenë objekt i asnjërit nga nenet që ka kopjuar nga Kushtetuta dhe Ligjet, paditësi.

4-Do të vërtetoj se pavarësisht se nuk kanë asnjë vlerë juridike e nuk përbëjnë asnjë cenim moral ato që kam shkruar në shkrimin tim publicistik, siç thashë në pikën 3 më lart, prapë se prapë unë nuk kam shkruar gjëra të paverifikuara mirë, e aq më pak “shpifje e konsumuar në publik” etj, siç pretendon paditësi në kërkesëpadinë e tij (shih faqe 2 të kërkesëpadisë, pika 2., paragrafi i parë dhe i dytë i saj). Bile edhe për faktet e njohura botërisht ose zyrtarisht për të cilat nuk ka nevojë të sillen prova se janë të vërteta apo jo, kjo sipas nenit 13 të Kodit të procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, ku thuhet: “Faktet e njohura botërisht ose zyrtarisht nuk ka nevojë të provohen”, unë edhe për këto po sjell prova!!!

Le të ndalojmë fillimisht, në një sqarim terminologjie gjë që do të ndihmojë në kuptimin e faktit se unë nuk e kam pasur fjalën vetëm për babën dhe nënën e paditësit, por për “etërit e familjes. Kam shkruar pra “etërit e familjes”, dhe jo “prindërit e të paditësit”, siç përpiqet ta kufizojë thënien time paditësi, me sa shkruan në pikën 13, në faqen 6 të Akt-Padisë, **ku Ai ndalon vetëm tek baba dhe nëna e tij. Unë kam shkruar pak më tutje se prindërit, kam kaluar edhe tek prindërit e motrat e nënës së tij, siç bëjnë rëndom kur duan të përshkruajnë qëndrimet e “etërve të familjes”. Këtë gjë e kam përcaktuar qartë, me shqipe të saktë. Me “etërit e familjes”, në shqip bëhet fjalë për “të parët” e familjes së paditësit, e jo thjeshtë për nënën e babën e tij, siç do dhe e keqkupton paditësi. Sa them del e qartë si nga konteksti ku shkruhet, si dhe nga Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe”, botim i “Akademisë së Shkencave”, ku në fjalën “Atë”, në kuptimin 2, shkruhet: “të parët”, pra këtu, “të parët e familjes”. Nëse fjala do të ishte për babën dhe nënën e paditësit, do të shkruaja “prindërit e tij”. Pra, duke pasur parasysh edhe kualifikimin e paditësit, përjashtohet keqkuptimi pa dashje, pra ai, **paditësi qëllimisht përmend vetëm nënën e babain e tij, pa përmendur të tjerët, p.sh. të atin e nënës së paditësit (i ndjeri Islam Haxhia), që e kam dëgjuar nga durrsakët e vjetër si një person me namin e një superkomunisti, ish aktivist edhe në lagje qytetit; akoma sot kujtohen bëmat e tij për goditjen “e të deklasuarve” (termi komunist për antikomunistët). Ka qenë Islam Haxhia, gjyshi i paditësit, që nga ka kontribuar në privimet e të drejtave jetësore të njerëzve (dhënia e shtëpive, të drejtave të punës, triskëtimit etj.), e deri tek internimet. Po le t’i marrim me radhë gjërat.****

Tani që sqaruar terminologjinë, po kthehem tek fakti se informacionin për familjen Mehmeti (sot Nishani), e kam marrë si në rrugë zyrtare, si dhe nga shumë fakte të njohura botërisht.

Në rruga zyrtare, informacioni është marrë në vitin 1992, kohë kur sapo isha rizgjedhur deputet dhe isha emëruar ministër i Rendit Publik dhe zëvendëskryeministër. Më ka ardhur në shtëpi, në Durrës, babai i paditësit, z. Faik Mehmeti. Në atë periudhë, familja Mehmeti (sot

Nishani) banonte përball apartamentit ku banoja unë, në anën tjetër të rrugës. Babai i paditësit, z. Nishani, kërkonte të interesohesha që të transferohej më pranë shtëpisë, një djalë që e kishte oficer diku nga Veri-lindja (mbase në Kukës), bëhej fjalë ose për vetë paditësin ose për vëllain e tij..

Kam pyetur në Partinë Demokratike Durrës, se cilët janë këta Mehmeti? Më kanë thënë sa vijon:

- a- Janë një familje e lidhur ngushtë me regjimin komunist, ku më i njohur për bëmat e tij ishte **gjyshi i paditësit babai i nënës së tij, Islam Haxhia**. Ai kishte **qenë partizan diku nga Vlora**, pas Luftës së Dytë Botërore **ushtarak**, i **çmobilizuar** më vonë me shkurtimet e personelit, **në Kavajë**, pastaj vjen në Durrës ku **punon në Komitetin Ekzekutiv të Rrethit, duke u aktivizuar shumë në luftën e komunizmit kundër të “deklasuave”**. Aktivizimi i të ndjerit Haxhia u zhvillua sidomos në strukturat e lagjeve, frontit Demokratik etj. **Në Durrës shpejt u bë i njohur si tmerri i atyre “me biografi të keqe” (sipas regjimit komunist), një njeri që bëhej fajtor direkt për sa e sa burgosje dhe internime, mos dhënie të drejte strehimi e shtëpie sa e sa nevojtarëve “me biografi të keqe”**
- b- Një motër e nënës së paditësit, pra **një teze e paditësit, zonja Shqipe Haxhia (Spiro), kishte punuar gjatë komunizmit në organet më të larta të diktaturës komuniste** (nga vitet 70, kur ishte fare e re, juriste, punonte në Prokurorinë e Përgjithshme, për një kohë bile në paradhomën e Prokurorit të Përgjithshëm të kohës së terrorit komunist) e pozicione të tjera të larta në sistemin e drejtësisë komuniste. Parantezë: prokuroria në kohën e komunizmit ishte organi më i frikshëm i shtetit komunist, në terrorizimin e popullatës.
- c- Dy prindërit e paditësit, Faiku dhe Tefta, ishin të dy arsimtarë. Zoti Faik kishte disa vjet që ishte mësues historie, **“rreth 40 vjet në gjimnazin e Durrësit”, shkruan edhe paditësi** (shih intervistën bashkangjitur “Nga babi ka pasur disa probleme, ndërsa nga pjesa e nënës jo). Faiku u mbahej mësimeve të PPSH. Znj. Tefta ishte arsimtare në ciklin e ulët, shkollë 8- apo 9-vjeçare, ku edhe ajo ishte konform politikës së PPSH.
- d- **Dërgimi i djemve të familjes Faik dhe Tefta Mehmeti, në shkolla ushtarake apo drejtësie komuniste**, në traditën e gjyshit dhe dajës, është një fakt i pakundërshtueshëm i lidhjeve të forta edhe të familjes së ngushtë të paditësit (prindërit), me shtetin komunist, sepse në atë kohë, në regjimin komunist në Shqipëri, në këto lloj shkollash shkonin vetëm njerëz nga familje të kontrolluara nga regjimi komunist, për qëndrimin e tyre qartë prokomunist. Aq më tepër pas vitit 1974, kur Enver Hoxha zgjeroi terrorin edhe brenda të vetëve, komunistëve: **pushkatoi, burgosi e internoi disa gjeneralë të ushtrisë, ish shokë të tij komunistë, duke u sajuar me juristët e tij, prokurorët e ushtarakët e tij, disa gjyqë farsë**. Në Shqipërinë komuniste, gjykatësit merrnin urdhra direkt edhe nga Komitetet e Partisë Komuniste në Rrethe.

Me gjithë informacionin e mësipërm, **unë vendosa ta ndihmoj z. Faik që t’i afrohej djali. Pra e dija shumë mirë se kërkesa për ndihmë vinte nga një familje me bëma në mbështetje të shtypjes komuniste të popullit, të kryera nga etërit e kësaj familjeje superkomuniste**. Pata biseduar që të shihej mundësia e transferimit të djalit të z. Faik, mbase vetë Bujari ose ndonjë vëlla i paditësit. Me sa mbaj mend, djali i z. Faikut u transferua. **(Për moralin e përhapur shqiptar, padija e Presidentit Nishani ndaj meje, e bën temë romani këtë rast: paditet për hiçgjë, njeriu që i ka bërë një nder të madh dikur!!!)**

Sqaroj se ndihma që po jepja për të plotësuar kërkesën e z. Faik Mehmeti, babait të paditësit, **bëhej duke e ditur se po ndihmohej një familje “me bëma në mbështetje të shtypjes**

komuniste të popullit, të kryera nga etërit e kësaj familjeje superkomuniste”, kjo për të dhënë mesazhin se kishte mbaruar koha kur fëmijët paguanin për fajet e të afërmeve të tyre, kishte mbaruar lufta e klasave aq e futur në çdo veprimtari të shtetit komunist, dhe aq e urryer nga një pjesë e madhe e popullit shqiptar. Në programin e PD të asaj kohe, që unë e zbatoja si politikan i kësaj force, por edhe se kisha si bindje vetjake se ishte një qëndrim shumë i drejtë, ishte e shkruar qartë që në shtetin e ri që po ndërtonim, duhet t’i jepej fund njëherë e mirë diskriminimit të njerëzve mbi bazë të biografive, që një kohë ndiqeshin nga komunizmi, deri në 7 brez”.

Fakte të njohura botërisht mbi etërit e familjes Nishani, pra familjes së paditësit i kam marrë nga bisedat me qytetarë durrsakë që në vitin 1970.

- a- Kur jam transferuar me punë nga Shkodra në Durrës, në vitin 1970, kisha në kujtesë një ngjarje shumë të dhimbshme, të para disa vjetëve, të ndodhur në Shkodër. Në një ndeshje boksi, viti 1959, ku unë kam qenë spektator, vdiq nga goditjet një boksier, një djalë i ri, shumë simpatik, shumë i pëlqyer nga ne tifozët shkodranë, pavarësisht se ai ishte boksier kundërshtar, i skuadrës Partizani, ishte nxënës në shkollën e mesme “Skëndërbej”. Edhe sot e kujtoj me dhimbje atë aksident. Kur erdha në Durrës, pra në vitin 1970, pyeta për të dhe familjen e tij. Më patën thënë se ai djalë vërtetë që kishte qenë një trëndafil, por që kishte lindur nga një ferrë, sepse babai i tij, që më vonë rezultoi që ishte gjyshi i paditësit ishte një persekutor komunist “shumë i keq”, që i kishte rënë në qaftë shumë durrsakëve në kuadrin e luftës së klasave të komunizmit, por dhe jo vetëm, e paraqisnin si një njeri të keq dhe si shpirt. Bëhej fjalë për gjyshin e paditësit, Islam Haxhiaj, për të cilin fola më lart.
- b- Gjatë viteve 2005 e deri sot, kur filloi t’i dëgjohet emri në politikë i paditësit, **kam dëgjuar vazhdimisht përsëritje të po këtyre opinioneve për etërit e familjes, nga çdo durrsak me të cilin kam biseduar.** Bile flitej se kjo familje, fillimisht mbante lidhje si me PD-në, si dhe me PS-në, kjo sepse në PS kishte shumë njerëz me prejardhje nga PPSH (partia komuniste e para vitit 1991), që mbanin akoma lidhje mbi bazë biografish, prejardhjeje.
- c- **Për nënën dhe babën e paditësit, flitet se kanë qenë arsimtarë të devotshëm në kuptimin komunist të fjalës. Nëse ata do të ishin “të goditur politikisht”, siç aludon paditësi, në kërkesëpadinë e tij (faqe 6 dhe 7, pika 13), nuk do t’i linte shteti komunist të ushtronin profesionin e arsimtarit mu në mes të Durrësit.** Arsimtarët e përndjekur u hoqën nga arsimi dhe u dërguan në profesione të tjera, kryesisht punëtor krahu. **Pas vitit 1990, nëna dhe baba i paditësit “ndenjën në punën e vet”, nuk përkrahën fare proceset demokratike, në ndryshim me sa bënë shumica e kolegëve të tyre arsimtarë, që edhe ata si familja Mehmeti apo Nishani kishin prejardhje nga familje superkomuniste, por ata “nuk ndenjën në punën e vet” si familja e paditësit, por u aktivizuan në proceset demokratike sepse ata e kuptuan që sistemi komunist duhej rrëzuar, dhe guxuan.**

Po e përmbledh duke thënë se **një familje me pjesëtarë me aktivitet në Prokurorinë e Shtetit komunist; në organizatën e frontit; që dërgonte disa pjesëtarë të saj në shkollat ushtarake komuniste. pasi ishin pushkatuar, burgosur e internuar sa e sa kuadro të ushtrisë; që i mbante dhe pedagog në këto shkolla ushtarake komuniste bijtë e kësaj familje; kjo familje me njerëz që ushtronin luftën e klasave në çdo çast në vendet e punës e të lagjes; të gjitha këto janë tipare më se të mjaftueshme që ta cilësosh atë familje si me “bëma në**

mbështetje të shtypjes komuniste të popullit, të kryera nga etërit e kësaj familjeje superkomuniste”.

5—Por unë, në aktivitetin tim si opinionist, nuk u mjaftova vetëm me sigurinë time se informacioni që po publikoja isht krejt i vërtetë dhe i njohur publikisht, por kërkova prapë që të verifikoheshin përsëri nga lexuesit. Këtë kërkesë a kam shkruar qartë në Shkrimin tim që po paditet sot dhe është objekt i këtij trajtimi gjyqësor. Në po atë shkrim, në një vend fare të dukshëm, u kam bërë prapë thirrje qytetarëve ta verifikojnë prapë sa po shkruaja për këtë familje. Unë kisha ezauruar të gjitha mundësitë e mia për të verifikuar të gjitha të dhënat për bëmat në mbështetje të shtypjes komuniste të popullit, të kryera nga etërit e kësaj familjeje superkomuniste, e me gjithë atë kërkoja prapë verifikim. Pra, jam “treguar me katolik se Papa”, duke vënë në dyshim edhe publikisht, këto të dhëna, që për shumicën dërmues të opinionistëve do të kishin qenë përfundimisht të sigurta në saktësinë e tyre, dhe do ta quanin fare të tepërt këtë thirrjen time për “super të vërtetën”, me të cilin mbyll, Shkrimin tim, si vijon:

“Apo i keni shpifur kësaj “familjeje të gjorë”!

Shkruani si është e vërteta.”

Nuk kisha sesi të isha më i saktë se kaq, në kërkimin e të vërtetës.

Kam dashur gjithnjë të jem i saktë në publicistikën time (kam shkruar mbi 700 shkrime, opinione, në gazetatat më të mëdha të vendit, duke pasur gjithnjë synimin e thënies së fakteve siç janë, pavarësisht mendimeve të mia). Në këtë kuadër, pra të kërkesës ndaj vetes, për të qenë 100% i sigurt për ato që shkruaja, megjithëse i kisha verifikuar personalisht dhe i thoshte kudo opinioni qytetar durrsak, iu drejtova qartë, e në vend të dukshëm lexuesve të shkrimit tim, me këto fjalitë mbyllëse të Shkrimit.

I takonte paditësit, Presidenti z. Nishani, të dalë publikisht në masmedia, dhe të thotë të vërtetën për të parët e familjes së tij, që, me shembullin e tij personal, të kontribuojë në shkrimin e vërtetë të historisë.

6—Kjo kërkesëpadi, të le shije të keqe, të keqpërdorimit të lidhjeve nga pozita e Presidentit dhe Kryetar të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Paditësi ka vënë në lëvizje gjykatën, duke e shtyrë në keqpërdorimin e kohës dhe të fondeve, duke shkaktuar shpenzime gjyqësore të panevojshme, si dhe shpenzime kohe të gjithë personave të tjerë që janë detyruar të angazhohen në përgjigje të kërkesëpadisë së tij.

Në vërtetim të dyshimeve te paragrafit të më sipër, kam edhe faktin shumë shqetësues që vijon:

Kërkesëpadia e ish-Presidentit akoma në detyrë, z. Nishani, është përpiluar të premten, dt. 31.03.2017 (data e saj), dhe mua posta më ka prurë thirrjen e parë për fillimin e seancave gjyqësore, si i paditur, më datë 07.04.2017, të premten, kur nuk isha më në Shqipëri. I bie që Gjykata e Rrethit Durrës ka kaluar të gjitha procedurat, që nga regjistrimi i kërkesëpadisë në Sekretari, tek dërgimi tek kryetarja e Gjykatës, tek hedhja e shortit për

caktimin e gjykatësit, e deri tek lajmërim i të paditurit, brenda 3-4 ditëve pune!!! Nga sa kam pyetur, **nuk bën ndonjë herë vaki, që për një çështje civile fare jo urgjente, si kjo e kërkesëpadisë që po trajtohet, të jetë vepruar me kaq shpejtësi.** Duket se urgjencën e prishi vajtja ime në Gjermani, që paditësi nuk e kishte parashikuar ...

Duket sikur me këtë proces gjyqësor, paditësi synon të marrë një certifikatë false të një familje të goditur nga komunizmi—nuk gjej dot arsye tjetër të gjithë kësaj që ka sajuar, me 9 faqe kërkesë padi, e me 4 faqe kopje identike të shkrimit tim prej veçse gjysmë faqeje.

Mbetet fakti që fatkeqësisht paditësi nuk ndoqi rrugën e ballafaqimit me publikun, por të ballafaqimit me mua në një proces gjyqësor, duke qenë President i vendit dhe kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, organ i emërimit të titullarëve të drejtësisë: një konflikt i turpshëm interesi, nga ana e tij.

7--Paditësi, me këtë kërkesëpadi, i kundërvihet edhe lirisë së shtypit, sepse indirekt kritikohen edhe të gjithë ato organe shtypi e mediash elektronike, që e kanë botuar Shkrimin në fjalë, sepse paskan “botuar shpifje”. Nuk qenkan pak organe, **po i sjell nga kërkesëpadi,** nga faqja 3, pika 3 e saj: “Gazeta Tema”, “Gazeta Dita”, “Lexo”, “Dritare.net”; “Java News”, “Newsbomb”.

Unë po shtoj edhe disa të tjera, meqë paditësi nuk ka dashur t’i sjellë emrat e tyre këtu, për arsye që nuk i thotë. **Ja masmediat që nuk ka dashur t’i përmendë paditësi:**

Gazeta Bulevard Durrës, organi i parë që botoi shkrimin që po gjykohet

<http://www.bulevardionline.com/bashkim-kopliku-zoti-president-heshtja-eshte-faj-kur-ushqen-genjeshtren/>

Alo Albania Lajme

<https://www.facebook.com/AloAlbania/posts/1399029436814717>

Nuk gjej dot legjislacion të specializuar që rregullon lirinë e shtypit në Shqipëri, sepse është shfuqizuar në vite legjislacioni i miratuar kur unë kam qenë deputet, 1991-97. Po të kishte ligj, do të përgjigjesha si më lart, konkretisht e duke caktuar nenet që shkel paditësi në kërkesëpadinë e tij.

Me ligjet e dikurshme, nuk lejohej që as përgënjeshtrimi i shkrimit të bëhej po thuaj 40 ditë pas botimit, siç ka bërë paditësi në rastin konkret (gazeta e parë që ka botuar shkrimin, është Bulevard Durrës, botuar më 21.02.2017.

Kur deputeti z. Sali Berisha, ishte kryeministri në qeverinë ku paditësi ishte ministër, pat dalë një akt ku shkruhej, pak a shumë: “Shkruani në shtyp çdo gjë, pa frikë se do të dënoheni për ato që shkruani”. Ai, u pat hequr të drejtën ministrave të vet, edhe paditësit, të shpinin në gjyq gazetarët e publicistët, në pozicionin e të cilëve jam unë sot e 15 vjet.

Në kohën që jetojmë, kudo në botën e përparuar, tendenca është mos të kufizohet liria e shtypit, siç po përpiqet të bëjë paditësi, Presidenti i vendit tonë!

8-Në mbyllje, po i përgjigjem edhe aludimeve të paditësit në kërkesëpadinë e tij, se unë iu kundërvënkam përpjekjeve të tija për hapjen e dosjeve të sigurimit, e se gjoja Shkrimin që po trajtohet në këtë proces, unë gjoja e paskam shkruar për "rezistencë të pashembullt" kundër procesit të hapjes së dosjeve etj. Ju lutem lexoni pikat 14 dhe 15 të Akt-Padisë.

Shkrimi nuk ka pasur fare këtë qëllim që thotë paditësi. Por, ai duket ka lexuar shkrimet e mia, në të cilat unë shpesh i jam kundërvënë vetëm hapjes së dosjeve, e të mbylljes së problemit të dekomunistizimit vetëm me kaq, siç ka luftuar të bëhet edhe Ai, paditësi. Kjo sepse vetëm hapja e dosjeve siç pretendon Ai, mbron fajtorët kryesorë të terrorit komunist, duke i fshehur pas dosjeve të zhdukura e të mbetura, e të manipuluar nga Sigurimi i Shtetit. Nuk ka kuptim ta bazosh dekomunistizimin vetëm në hapjen e dosjeve të cilat janë të manipuluar, si para prillit 1992, kur unë mora postin e Ministrit të Rendit Publik, si dhe mbase dhe gjatë këtyre 25 viteve më pas. Unë mendoj se në Shqipëri, si rezultat i këtij manipulimi të madh të dosjeve, por edhe të arshivave, nuk mund të ndiqet rruga gjermane dhe e shumë vendeve të tjera, të cilat kanë pasur arshiva shumë më të paprekura. Tani edhe në Gjermani, kanë dalë institucione kundër Arshivave komuniste, sepse edhe atje, ka rezultuar se nëpërmjet tyre janë arritur shpesh në konkluzione të gabuara, kanë shpëtuar fajtorë, dhe janë akuzuar të pafajshëm. Për të dënuar terrorin komunist, rruga shqiptare nuk duhet të jetë në radhë të parë dhe vetëm hapja e dosjeve të Sigurimit, dhe kaq, por në radhë të parë kufizimi me ligj i të drejtave të personave të përlyer në terrorin komunist, me ligje të dekomunistizimit, sepse shumica e fakteve janë jo në dosjet e mbetura të sigurimit, por haptas, në institucione të tjera (ish-zyra kuadri etj.), që dihen botërisht nga njerëzit që sot janë gjallë. Duhet bërë pra një dekomunistizim, tip vettingu që po bëhet për sistemin e drejtësisë dhe për dekriminalizimin e Kuvendit, edhe për dekomunistizimin e gjithë administratës së shtetit, dhe të arsimit, qoftë shtetëror qoftë privat. Nuk po e zgjas këtë argument: kush do të hyjë më thellë në mendimet e mia, i rekomandoj të lexojë **mendimet e mia për hapjen e dosjeve që unë kam shfaqur direkt e publikisht, në masmedia, ku në vijim po ju bie një listë të vetëm 14 shkrimeve të mia që kanë këtë temë.**

	Titull i shkrimit	Gazeta	Data e botimit
1.	Prapë, mbrojtje e komunizmit me spiunët	Sot	05.04.2012
2.	Keqpërdorimi i përndjekjes	Gazeta Shqiptare,	21.2.2009
3.	Justifikimi i puçit kushtetues	Gazeta Shqiptare,	10.2.2009
4.	Testi i patriotizmit të gjykatës kushtetuese	Gazeta Shqiptare	3.2.2009
5.	Ligj për të shpëtuar mëkatarët	Gazeta Shqiptare	26.7.2008
6.	Pas 13 vjetëve, prapë shkelje e Kushtetutës	Gazeta Shqiptare	23.12.2008
7.	Rehabilitimi ligjor i komunizmit	Gazeta Shqiptare	17.12.2008
8.	Kushtetuta dhe "hapja e dosjeve"	Gazeta Shqiptare	12.07.2008
9.	Verifikimi, certifikatë mirësjelljeje për spiunët[,]	Gazeta Shqiptare	10.7.2008
10.	Klasifikimi i "Spiunëve"	Gazeta Shqiptare	5.7.2008

- | | | | |
|-----|-----------------------------------------------------------------------------------------|------------------|------------|
| 11. | Berisha, njeriu më i korruptuar, s'kërkon para e vila por pushtet" INTERVISTE | Gazeta Shqiptare | 31.8.2006 |
| 12. | Dosjet e gjalla | Gazeta Shqiptare | 11.11.2006 |
| 13. | "Dosjet?!- nuk ia vlen", botuar me titullin "Të hapen dosjet apo jo?" | Panorama | 16.03.2005 |
| 14. | Të kundërshtosh doktorin?!, u botua me titull "Ç'do të thotë të bësh sherr me Doktorin" | Gazeta Shqiptare | 8.4.2006 |

Po e mbyll këtu, njëherë për një herë, parashtrimin tim kundër kërkesëpadisë.

Besoj se kam shkruar mjaft sa që zonja gjykatëse të bindet për kotësinë, pabazueshmërinë në ligj e në moral të kërkesëpadisë.

Kërkoj rrëzimin e padisë.

Nderime

I padituri

Bashkim Kopliku

Durrës, më 09.05.2017

Mobile: +355(0)672858090

Phone: +355(0)52 223663

E-mail: bkopliku@gmail.com

Adresa: L. 12, Rr. Mozaikëve, P. 917, Durrës

Pjesë e këtij parashtrimi janë edhe 4 dokumentet bashkangjitur, në vijim:

1--Kërkesë për korrigjime gabimesh në kërkesëpadinë e datës 30 mars 2017, të paditësit z. Bujar Nishani, ndaj të paditurit z. Bashkim Kopliku, 4 faqe

2--Zoti president, heshtja është faj, kur ushqen gënjeshtren, (Botuar dt. 21.02.2017, Durrësi Bulevard); 1 faqe;

3-- Nga babi ka pasur disa probleme, ndërsa nga pjesa e nënës jo; 1 faqe

4-- Ilir Meta: Ditën që vdiq Enver Hoxha, babai më qëlloi me shpullë, e donte shumë; 1 faqe